



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 195

Tiranë – E mërkurë, 8 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

| | | Faqe |
|---|--|------|
| Dekret i Presidentit nr. 10637, datë 2.11.2017 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... | 9495 |
| Dekret i Presidentit nr. 10638, datë 3.11.2017 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... | 9495 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 6.11.2017 | Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje..... | 9495 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 6.11.2017 | Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë..... | 9498 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 6.11.2017 | Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Tunizisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike..... | 9502 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 6.11.2017 | Për ruajtjen dhe mbrojtjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të personelit vendas dhe ndërkombëtar, të objekteve ku ushtrojnë veprimtarinë, si dhe Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga Garda e Republikës së Shqipërisë..... | 9503 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 6.11.2017 | Për emërim në detyrë..... | 9504 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 6.11.2017 | Për emërim në detyrë..... | 9504 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 6.11.2017 | Për emërim në detyrë..... | 9504 |

| | | |
|---|---|------|
| Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 2231, datë 3.11.2017 | Për delegim të kompetencave..... | 9504 |
| Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 10, datë 31.10.2017 | Për një shtesë në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë..... | 9505 |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 567, datë 1.11.2017 | Për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Preng Luli..... | 9505 |
| Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 15581, datë 7.11.2017 | Mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare..... | 9507 |

**DEKRET**

Nr. 10637, datë 2.11.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ilire Agim Koci
2. Eroll Sabit Prestreshi
3. Mohammad Ahmad Altarawneh
4. Fethi Bahri Kaya

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10638, datë 3.11.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministres së Kulturës,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Besa Rrustem Shahini
2. Hajrulla Ilir Çeko
3. Valbona Sadedin Shujaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 638, datë 6.11.2017

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR
DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si një institucion juridik, publik, në varësi të Kryeministrit. Agjencia ka selinë në Tiranë dhe ka vulën e stemën e saj.

2. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka si mision ofrimin direkt të shërbimeve publike, për të garantuar bashkëqeverisje e gjithëpërfshirje në politikëbërje dhe vendimmarrje, nëpërmjet ndërveprimit në platformën elektronike “Me ty, për Shqipërinë që duam” të qytetarëve, organizatave jofitimprurëse e sipërmarrjes private me administratën shtetërore dhe institucionet qeverisëse, si dhe mbështetjen e projekteve e të programeve për një shoqëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve, shoqërisë civile, rinisë dhe aktorëve të tjerë, në fusha të ndryshme, si: inovacioni, krijimtaria, transparenca, arsimiti, rinia, shkenca, arti, kultura, grupet vulnerabël.

3. Agjencia, për të realizuar misionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, kryen funksione administrative dhe detyrat e mëposhtme:

a) Siguron përgjegjshmërinë e institucioneve të administratës publike gjatë ndërveprimit me qytetarët, në platformën elektronike “Me ty, për Shqipërinë që duam”, duke garantuar që në



bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë, për të gjitha mesazhet, nismat, ankesat apo kërkesat e dërguara, qytetarët të marrin një trajtim e përgjigje në cilësinë dhe kohën e duhur.

b) Trajton, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë, nismat me interes publik, të ardhura nga qytetarët, apo iniciativa të tilla nga organizatat jofitimprurëse dhe/ose sipërmarrja, të cilat kërkojnë mbështetje.

c) Trajton, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë, propozimet dhe idetë për projekte e reforma të qeverisë.

ç) Trajton dhe organizon kërkesat për interpelancë drejtuar Kryeministrit, zëvendëskryeministrit, ministrave specifike apo një grupi prej tyre.

d) Trajton dhe analizon vlerësimet e qytetarëve për cilësinë e shërbimit të ofruar nga administrata publike.

dh) Trajton e koordinon, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e varësisë, iniciativat e qytetarëve në fushën e arsimit, lidhur me projekte në dobi të shkollave publike.

e) Trajton e koordinon, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e varësisë, denoncimet për sjelljet abuzive apo korruptive, të ardhura nga qytetarët dhe sipërmarrja.

ë) Bashkëpunon me ministritë e linjës, institucionet e varësisë, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare, në mbështetjen dhe promovimin e projekteve, aktiviteteve, nismave, bashkëpunimeve për një shoqëri të institucioneve të hapura dhe të dialogut të gjerë.

f) Bashkëpunon me ministritë e linjës, institucionet e varësisë, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare të shkencës, arsimit, artit, kulturës, në mbështetje dhe për promovimin e një imazhi të ri për vendin tonë e rajonin, si simbole të bashkëjetesës paqësore dhe udhërrëfyes në ndërtimin e saj.

g) Zbaton e kontribuon në strategjitë dhe politikatat e qeverisë në mbështetje të studiuesve, artistëve, rinisë, qendrave të ekselencës, të hulumtimit dhe komunikimit.

gj) Zbaton strategjitë qeveritare për krijimin e mjeteve dhe kontribuon për mbështetjen e nismave inovative të dialogut, bashkëpunimit e të bashkëjetesës në rajonin tonë.

h) Zhvillon bashkëpunime dypalëshe dhe shumëpalëshe me sektorin publik e privat, vendës dhe të huaj, në shërbim të misionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

i) Kontribuon në krijimin e kushteve për bashkëpunimin e intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet politikëbërësve dhe akademikëve, ekspertëve të shquar ndërkombëtarë, personaliteteve në fusha të ndryshme.

j) Kontribuon në zhvillimin e politikave, të legjislacionit, strategjive për inovacionin, krijimtarinë, transparencën, arsimin, rininë, shkencën, artin, kulturën, grupet vulnerabël, për institucione më pranë qytetarëve dhe shoqërisë civile.

k) Propozon e inicion nisma dhe menaxhon qendra në përbushje të misionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, brenda dhe jashtë vendit, mbështetur në legjislacionin shqiptar ose në bazë të marrëveshjeve dy-a shumëpalëshe.

l) Realizon dhe financon projekte inovative të studentëve, studiuesve, artistëve, kuratorëve, gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, për sigurimin e mjeteve e të mundësive për ndikimin e politikave publike dhe krijimin e një dialogu të gjerë, që siguron institucione të hapura, transparente e më pranë qytetarëve.

4. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucion buxhetor dhe financohet nga:

- a) buxheti i shtetit;
- b) burime të tjera të ligjshme.

5. Organet e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje janë:

- a) Drejtori i Përgjithshëm (organ drejtues);
- b) Bordi Këshillimor.

6. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e agjencisë.

7. Drejtori i Përgjithshëm emërohet, shkarkohet dhe lirohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit.

8. Bordi Këshillimor është organ kolegjal këshillimor, që drejtohet me rotacion 6-mujor nga anëtarët e tij.

9. Bordi Këshillimor miratohet me urdhër të Kryeministrit dhe përbëhet nga 15 anëtarë, shqiptarë e të huaj, të njohur për veprimtari në lidhje me misionin dhe fushat e veprimit të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.



10. Bordi Këshillimor ka në përbërje të tij:

- anëtarë/drejtues të organizatave shqiptare të shoqërisë civile;

- pjesëtarë të trupit diplomatik, të akredituar në Shqipëri;

- anëtarë/drejtues të dhomave/unioneve të tregtisë shqiptare dhe të huaja;

- ekspertë, akademikë, profesorë të universiteteve prestigjioze, shqiptare dhe të huaja;

- përfaqësues të institucioneve të ngjashme, publike ose private, të vendeve të tjera;

- ekspertë të njohur, të huaj dhe vendës, me kontribut ose potencial për kontribut në misionin e agjencisë.

11. Bordi Këshillimor ka këto funksione:

a) Propozon ndryshime në kalendarin e aktiviteteve të agjencisë dhe miraton raportin e veprimtarisë, i cili i dërgohet Kryeministrit dhe bëhet publik;

b) Propozon aktivitete, programe, projekte për agjencinë;

c) Sugjeron ndryshime në programet, financimet dhe projektet, në të cilat përfshihet agjencia;

ç) Ka të drejtë të japë vlerësime për të gjitha llojet e kontratave, në të cilat përfshihet agjencia.

d) Ka të drejtë të japë sugjerime për përfaqësimin e agjencisë pranë palëve të treta;

dh) I sugjeron agjencisë angazhime në marrëdhënie dypalëshe e shumëpalëshe me palë të treta, brenda dhe jashtë vendit.

12. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje mbështetet, për çështjet e përmbajtjes e të vlerësimit të programeve e projekteve, në ekspertizën e anëtarëve të Bordit Këshillimor ose në ekspertizën e komisioneve të programeve e të projekteve që propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm, në konsulencë me bordin dhe në përputhje me rregulloren e funksionimit të kësaj agjencie.

13. Struktura dhe organika e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Funksionimi i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje rregullohet në përputhje me rregulloren e funksionimit të kësaj agjencie, e cila përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me bordin, dhe miratohet me urdhër të Kryeministrit.

15. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të agjencisë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

16. Buxheti për vitin 2017, projektet në zbatim, dokumentacioni dhe pajisjet e Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (AMQDH), krijuar me vendimin nr. 814, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (AMQHD)”, i transferohen Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

17. Nëpunësit ekzistues të strukturës aktuale të Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (AMQHD) transferohen pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

18. Vendimi nr. 814, datë 7.10.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (AMQHD)”, shfuqizohet.

19. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 639, datë 6.11.2017****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE
TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË
AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË
ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA
BASHKIMI EVROPIAN, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë gjithsej 21 veta.

4. Vendimi nr. 930, datë 28.12.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



Skema 1

STRUKTURA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN



SKEMA 2

ORGANIKA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN

| POZICIONI | KATEGORIA | NUMRI |
|--|-----------|----------|
| I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM | II-a | <u>1</u> |
| II. ZËVENDËSDREJTOR I PËRGJITHSHËM | II-b | <u>1</u> |
| III. DREJTORIA E AUDITIMIT TË PROGRAMEVE IPA | | (7) |
| DREJTOR | II-b | 1 |
| AUDITUES I PARË | II-b | 3 |
| AUDITUES I DYTË | III-a | 3 |
| IV. DREJTORIA E AUDITIMIT TË PROGRAMIT IPARD | | (5) |
| DREJTOR | II-b | 1 |
| AUDITUES I PARË | II-b | 2 |
| AUDITUES I DYTË | III-a | 2 |



| POZICIONI | KATEGORIA | NUMRI |
|--|-----------|------------------|
| V. DREJTORIA E FINANCËS DHE JURIDIKE | | (7) |
| DREJTOR | II-b | 1 |
| SEKTORII FINANCËS DHE ADMINISTRATËS | | (3) |
| PËRGJEGJËS SEKTORI | III-a/1 | 1 |
| SPECIALIST (BUXHET, FINANCË) | IV-a | 1 |
| SPECIALIST (BURIME NJERËZORE/ARKIV PROTOKOLL) | IV-a | 1 |
| SEKTORI JURIDIK DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË | | (3) |
| PËRGJEGJËS SEKTORI | III-a/1 | 1 |
| SPECIALIST (JURIST) | IV-a | 1 |
| SPECIALIST (MARRËDHËNIE ME JASHTË) | IV-a | 1 |
| <u>PUNONJËS GJITHSEJ</u> | | <u>21</u> |

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA



VENDIM

Nr. 640, datë 6.11.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TUNIZISË, PËR
HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Tunizisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TUNIZISË
PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT
E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Tunizisë, më poshtë të referuara si Palët Kontraktuese,

Duke dëshiruar të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të tyre,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, do të hyjnë në territorin e palës tjetër kontraktuese pa vizë dhe do të qëndrojnë për një periudhë maksimale prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e hyrjes.

Neni 2

1. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, të dërguar për të punuar si anëtarë të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, si dhe organizatave ndërkombëtare të vendosura në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, do të lejohen të hyjnë pa viza në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1) zbatohen edhe për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta në të njëjtën familje dhe zotërojnë pasaportë të vlefshme diplomatike.

Neni 3

Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të një pasaporte të vlefshme diplomatike, do të hyjnë, dalin ose kalojnë tranzit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në çdo pikë kalimi kufitar të caktuar për trafik ndërkombëtar.

Neni 4

1. Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, mbajtës të një pasaporte diplomatike, do të respektojnë ligjin dhe rregulloret e Palës tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e asaj Pale.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve Kontraktuese për të refuzuar hyrjen ose anulimin e qëndrimit për shtetasit e Palës tjetër, të cilët ajo mund t'i konsiderojë si persona *non grata*.

Neni 5

1. Me synimin për të mbrojtur sigurinë kombëtare, paqen dhe rendin publik, si dhe shëndetin e shtetasve të tyre, Palët Kontraktuese do të kenë të drejtë të pezullojnë zbatimin e kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht.

2. Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën në lidhje me vendimin për pezullimin e kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht, ose për rihyrjen në fuqi nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë specimene të pasaportave të tyre diplomatike përkatëse të vlefshme brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e



hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimin e këtyre specimeneve gjashtëdhjetë (60) ditë para se ndryshimi të hyjë në fuqi.

3. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë specimene të pasaportave diplomatike të reja ose të ndryshuara, duke përfshirë të dhëna në lidhje me përdorimin e tyre të paktën tridhjetë (30) ditë para paraqitjes së specimeneve.

Neni 7

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8

Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund të ndërpresë në çdo kohë marrëveshjen, duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ky përfundim do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

Palët Kontraktuese, me pëlqim të ndërsjellë, mund të paraqesin ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje. Këto ndryshime do të përbëjnë pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje dhe do të hyjnë në fuqi sipas të njëjtës procedurë të përcaktuar në nenin 9 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit Pala Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të sa më sipër, përfaqësuesit nënshkrues, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në Nju-Jork, më 19.9.2017, në dy kopje në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze. Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ditmir Bushati

MINISTËR PËR EUROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË TUNIZISË

Khemaïs Jihoui

MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME

VENDIM

Nr. 641, datë 6.11.2017

**PËR RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E
ANËTARËVE TË INSTITUCIONEVE TË
RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË
GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE, TË
PERSONELIT VENDAS DHE
NDËRKOMBËTAR, TË OBJEKTEVE KU
USHTROJNË VEPRIMTARINË, SI DHE
INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
INSPEKTORATIT TË LARTË TË
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË
INTERESAVE, NGA GARDA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “c” e “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Garda e Republikës së Shqipërisë të ruajë dhe të mbrojë, me truporë/shofer (nënoficer), si më poshtë vijon:

a) Kryetarin dhe komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;

b) Kryetarin dhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit;

c) Komisionerët Publikë;

ç) Vëzhguesit ndërkombëtarë të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit;

d) Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

2. Garda e Republikës së Shqipërisë të ruajë dhe të mbrojë objektet (mjediset e punës), ku ushtrojnë



veprimtarinë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisionerët Publikë dhe vëzhguesit ndërkombëtarë të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 643, datë 6.11.2017

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Besa Shahini emërohet zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 644, datë 6.11.2017

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Valbona Shujaku emërohet zëvendësministër i Kulturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 645, datë 6.11.2017

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Hajrulla Çeku emërohet zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 2231, datë 3.11.2017

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, neni 26 i Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar me urdhrin nr. 150, datë 26.9.2017,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave që lidhen me procedurat e verifikimit të sigurisë së individëve që aplikojnë për CSP dhe operatorëve ekonomikë që aplikojnë për CSI, z. Mark Ndreca me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.

2. Autorizoj z. Ndreca të kryejë veprimet si më poshtë:

a) Të firmosë shkresat drejtuar autoriteteve verifikuese për verifikimin e sigurisë.

b) Të firmosë shkresat me të dhënat e OE-së të certifikuar përshtatshëm drejtuar autoriteteve kontraktore.



c) Të firmosë shkresat për përditësimin e rekordeve të OE-së të certifikuar përshtatshëm drejtuar autoriteteve kontraktore dhe OE-së.

d) Të firmosë shkresat përcjellëse për dërgimin e CSP-së tek institucionet shtetërore.

3. Ky urdhër do të jetë në fuqi deri më datë 31.12.2017.

4. Z. Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Mark Ndreca, Drejtor i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial; dhe Arkiv/Protokoll i DSIK-së.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
Dorian Tola

VENDIM
Nr. 10, datë 31.10.2017

**PËR NJË SHITESË NË NORMAT
TEKNIKO-PROFESIONALE DHE
METODOLOGJIKE TË SHËRBIMIT
ARKIVOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 8, të vendimit nr. 360 të Këshillit të Ministrave, datë 21.4.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, me propozim të Kryetarit, Këshilli i Lartë i Arkivave

VENDOSI:

Në “Norma tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” të bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas nenit 12 shtohet neni 12/1, me këtë përmbajtje:

“Dokumenti elektronik, që është pjesë e një praktike shkresore, printohet dhe i bashkëngjitet kësaj praktike.”.

2. Pas nenit 33 shtohet neni 33/1, me këtë përmbajtje:

“Afati i ruajtjes së dokumentit elektronik dhe që është pjesë e një praktike dokumentesh elektronike, përcaktohet nga Komisioni i Ekspertizës së institucionit, sipas listës me afatet e ruajtjes.”.

3. Ngarkohen të gjitha autoritetet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

VENDIM
Nr. 567, datë 1.11.2017

**PËR SHPALLJEN E PAVLEFSHMËRISË
SË MANDATIT DHE PËRFUNDIMIN E
PARAKOHSHËM TË MANDATIT TË
ANËTARIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË
SHKODËR, Z. PRENG LULI**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 1.11.2017, me pjesëmarrjen e:

| | |
|-----------------|-----------------|
| Klement Zguri | kryetar |
| Denar Biba | zëvendëskryetar |
| Bledar Skënderi | anëtar |
| Edlira Jorgaqi | anëtare |
| Gëzim Veleshnja | anëtar |
| Hysen Osmanaj | anëtar |

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Preng Luli.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 2, pika 1, germa “c”, neni 4, pika 3, neni 10, pika 1, germa “d” dhe neni 14, i ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu I i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjo diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike për këshilltarin në Këshillin Bashkiak.



Z. Preng Luli, anëtar i Këshillit të Bashkisë Shkodër, në datën 3.5.2016, ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit me numër unik 1508. Në bazë të formularit të vetëdeklarimit, z. Preng Luli nuk ka deklaruar asnjë vendim penal të formës së prerë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreut I, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja, me shkresën nr. 2452/1, datë 19.5.2016, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ, ndër të cilët ka qenë edhe emri i z. Preng Luli.

Në përgjigje të shkresës nr. 3682/2 prot., datë 9.6.2016, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikim i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Preng Luli, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Shkodër, si dhe nga shqyrtimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, z. Preng Luli rezulton të jetë i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është dërguar shkresa nr. 992/2 prot., datë 2.10.2017, të Prefekturës Qarku Shkodër, me objekt “Për njohje dhe zbatim të urdhrat të ekzekutimit nr. 1483, datë 16.9.2017”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për z. Preng Luli.

Sipas shkresës përcillen vendimet për të cilat është gjykuar anëtar i Këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Preng Luli.

Për z. Preng Luli rezulton të ketë:

- Një vendim gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 748 (3822), datë 28.9.2015, për kryerjen e veprave penale, “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3, i Kodit Penal, nëpërmjet së cilit është shpallur i pafajshëm.

- Një vendim gjyqësor të Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 533, datë 7.12.2016, për kryerjen e veprave penale, “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3, i Kodit Penal, nëpërmjet së cilit është deklaruar fajtor dhe është

dënuar me 3 (tre) vjet burgim, në aplikim të nenit 406 KPP i është zbritur 1/3 e dënimit dhe është dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim dhe i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare).

- Një vendim gjyqësor të Gjykatës së Lartë nr. 00 - 2017 – 501 (87), datë 8.6.2017, për kryerjen e veprave penale, “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3, i Kodit Penal, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit.

Referuar germës “c”, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nuk mund të kandidojnë, të zgjidhen apo ushtrojnë funksionin e Këshilltarit në Këshillin Bashkiak, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 (dy) vjet burgim.

Z. Preng Luli është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale, “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, dhe është dënuar me 3 (tre) vjet burgim dhe i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare).

Në këto kushte, vepra penale për të cilën është dënuar z. Preng Luli përfshihet në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar në nenin 2, pika 1, germa “c” e ligjit 138/2015.

Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë së cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për personat që parashikohen nga shkronja “c”, të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar masës së dënimit dhe datës kur ka filluar ekzekutimi i dënimit, dënimi duhet të



përfundojë më datë 8.6.2020. Periudha e ndalimit të ushtrimit të funksionit zgjat për një periudhë kohore prej 2 (dy) vitesh, deri më datë 8.6.2019.

Në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për personat që parashikohen nga shkronja “c”, të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, z. Preng Luli anëtarit i Këshillit të Bashkisë Shkodër, është brenda periudhës së ndalimit të ushtrimit të funksionit deri më datë 8.6.2029.

Nga shqyrtimi i të dhënave të dërguara me shkresën nr. 999/2 datë 2.10.2017, nga Prefektura e Qarkut Shkodër, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me “Njohjen dhe zbatimin e urdhrat të ekzekutimit”, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, bazuar në germën “c”, pika 1, neni 2, nenin 4, pika 3, i ligjit 138/2015, funksionari publik z. Preng Luli është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 10, pika 1 e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:

Kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja:

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit, kur kushtet e pazgjidhshmërisë dhe moskandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit, si dhe njofton Kryeministrin në rastin e Kryetarit të Bashkisë apo të Këshilltarit Bashkiak.

Për sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 179/a të Kushtetutës, nenit 10, pika 1, germa “d”, dhe nenit 14 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik, z. Preng Luli.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 179/a të Kushtetutës, në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i

ndryshuar; neni 2, pika 1, germa “c”, neni 4, pika 3, nenit 10, pika 1, germa “d” dhe nenit 14, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu I i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Preng Luli.

2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Klement Zguri

NJOFTIM
Nr. 15581, datë 7.11.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë (përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim, SIDA) për programin “Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri 2017-2020”, nënshkruar më 16.2.2017, hyrë në fuqi më 26.10.2017.

2. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për mbrojtjen shoqërore dhe protokollit përfundimtar të saj, nënshkruar në Tiranë, më 23.9.2015, hyn në fuqi më 1.12.2017.

3. Konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal mbi tatimin mbi të ardhurat”, nënshkruar më 5.4.2010, hyn në fuqi më 1.1.2018.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi
Faqe | 9507

| | |
|--|-----------------|
| | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë